

[illegible]

1944-1950

1945 - 1943


Është një nga proceset e para gjyqësore që çoi në ekzekutimin dhe dënimin me shumë vite burg të person-
alitetve që dyshoheshin si kundërshtarë të sistemit komunist. Ky proces, i quajtur Gjyqi Special i Tiranës, zhvilloi
31 seanca nga 1 marsi deri më 13 prill 1945, duke gjykuar 60 nacionalistë të akuzuar si kriminelë lufte: 17 prej
tyre u dënuan me pushkatim, 8 me burgim të përjetshëm dhe të tjerët me dënime të ndryshme me burg.

Lista e 37 të pandehurve dhe mbrojtja e Beqir Valterit në dosjet e vitit 1945

Arkivi i Sigurimit administron dosjet gjyqësore Nr. 12551.1 (1568) dhe Nr. 1255-1 +1568 të vitit 1945, që lidhen me procesin ndaj Fejzi Alizotit, Terenc Toçit, Aqif Përmetit dhe të tjerëve. Këto dosje përmbajnë materiale në gjuhën frënge dhe italiane, deklarata me shkrim dore, procesverbale dhe raporte hetimore për një numër të madh të pandehurish, të akuzuar për bashkëpunim me pushtuesit dhe veprimtari antikomuniste. Një document tjetër i përzgjedhur nga dosjet përfshin edhe listën e 37 personave që do të kalonin të parët në gjyq, një faqe e marrë nga dosja gjyqësore Nr. 12551.1 me titull “Fejzi Alizoti, Aqif Permeti etj.”. Publikimi i këtij materiali synon të sjellë në vëmendje një burim me vlerë historike, që ndihmon në kuptimin e rolit, qëndrimeve dhe mbrojtjes së tij përpara gjykatës. Në platformë publikohet këtë herë dokumenti i mbrojtjes së Beqir Valterit, një figurë e përfshirë në ngjarje të rëndësishme historike të Shqipërisë. Më 23 shkurt 1924, ai kreu një atentat ndaj kryeministrit Ahmet Zogu brenda Kuvendit, duke e plagosur lehtë me dy plumba; më pas u arrestua, por u lirua nga qeveria e Fan Nolit, vendim që shkaktoi reagime të forta. Në vijim, gjatë pushtimit italian dhe gjerman, Valteri mbajti poste të larta, ndërsa në vitin 1945 u dënua me pushkatim në Gjyqin Special si “kriminel lufte”

Lista e 37 personave që do të kalonin në gjyq të parët

MEDIA FAQE #1



Lista e 37 personave që do të kalonin në gjyq të parët

INFORMACION

Lista e 37 personave që do të kalonin në gjyq të parët


FONDI	Hetimor-Gjyqësor
-------	------------------

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #1



Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #2

ba antarë i një shoqërie patriotike që kish themeluar Avni Rustemi në San-Dimitrio-Corone t'Italis.Po në rund të këtij moti,Lidhja Patriotike e studentave shqiptarë të Romës që quhej Shoqëria Shpresa,më ngarkoi përfaqësues të sajë në Shqipëri për me mbledhë ndihma.Letër përfaqësimit e ka pasë firmuar sekretari i Shoqërisë Vasil Ziu,sot Kryetar i Frontit Nacional Çlirimtar të Durrësit.

Me 1921,me sygjërmin t'em që i pata ba Vasil Bidoshit,asht formue në Napoli shoqëria patriotike e Studentave Shqiptarë "NAIM FRASHERI".

Me 1922,drejtë për së drejti,prej inisjativës s'eme,asht formue në qytetin Lecce (Itali) një shoqëri tjetër nën emrin "ISKAJL QEMALI".Ket mund të m'a vertetojnë shokët e kolegjit si Dr.Bemzi Kico,Abaz Omari,Namik Cakrani,Steran Shundi etj.

Me 1923,po prej inisjativës s'eme,asht formue në Korçë një shoqëri tjetër nën emrin "YLLI I MENGJESIT".Kjo shoqëri përbahej prej nxënësve të krahinave të ndryshme të Shqipërisë që kishin ardhë në Liceun e Korçës.Por,ma vonë,mbas disa muejve,për mos me qenë të ndamë prej rinis korçare,me bashkëpunimin e disa shokve korçarë,formuem një shoqëri të përbashkët nën emrin "SHPRESA".Kjo shoqëri ka pasë nxënës edhe një organ të përfaqësues e,dhe unë kam qenë një nga redaktorët e sajë.Artikujt e mij edhe sot mund të gjinden në Bibliotekën Kombëtare:Rivista Shpresa Nr.1 e 2. dhe aktivitetin t'em përgjithësisht mund të m'a vertetojnë të gjithë shokët e Liceut si:Aleko Tashko,Dr.Sinan Ismail,Petraq Pepo etj.etj.

Po në vitin 1923,gjithnji me entuziazëm të madh për me i shërbye sa ma shumë qeshtjes kombëtare,tue pa trathëtit e krimet e Ahmet Zogut si edhe mënimin e popullit kundra tij,unë pata guxue për me atentue jetën e trathëtorit tue dalë në shesh vullnetarisht.Kët ngjarje e vërteton vet historia e Shqipërisë së kës dhe mbasi fati i keq më solli që të gjykoheh sot para jush si "trathëtor"! tash më duhet pak edhe me u levdue:

Veprën e kryva në mënyrën që i bante nderë djelmënis shqiptarë.I dhasa tiranit tri plaga revolveri kur ay ish diktator fuqipotë i vendit dhe i rrethuem me dyzina cuba t'armatosun.Kam edhe ma:

Kur i dola para tiranit për me i ra e për me e shtri,gjoksia t'em e pata mbështjellë me një flamur kombëtar.E,mbropa me mbrojtjen që bana për ma se një orë kundra cubave të tij që shtijeshin pa pra kundra meje,plumbat e tyne i prita me pushtë e kangë kombëtare në gojë.

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #3

Në krismat e pushtave pata këndue at kangën e Hilë Mosit:"Atje n'at vend të lamun,me gjak arbnorit t'fllrë"...Ket mënyrë veprimi,në mes shumë të tjerëve mund të ja u vertetoj dhe ish shoku i jem - e sot vetëm i jueji - Sejrulla Malëshova i cili ka ndodhë në Parlament kur u ba ngjarja dhe u burgos së bashku me mua.

Mbas disa muejve burg të randë me tortura e mandej mbas gjashtë muej liri dhe aklamacioni nën qeverinë revolucionare të Fan Nolit,në mes qindra intelektualësh që morën rrugën e ekzilit tue hixë nga ardnja e Zogut në fuqi,natyrisht qesh edhe unë.

JETA E JEMË N'EKZIL

Dhe n'ekzilit,ndonse isha fare i ri e kam qenë gjithnji i përsekutuem prej agjentave të Zogut,nuk mbeta pa veprue:

Me anën e një grupi të vogël që pata formue në Paris nën emrin:BASHKIMI I DJELMËNIS",kam luftue rrebtas tiranin e Zogut dhe penetracionin italian në Shqipëri tue i drejtue Lidhjes së Kombeve e kancelerive memorandumë e telegrame protestimi.E kam pasë qvësë Ahmet Zogun përpara opinjonit europjan e i kam luftue të gjitha lishjet që pat ba Roma me Qeverinë e Zogut. Ket shoqëri e pata formue me disa studenta,puntorë e ish-oficera të hikun dhe,aktivitetin t'em mund të m'a vertetojnë të gjithë shqiptarët që janë ndodhun në Paris.

Mbas shumë veprimeve të ndryshme në fushën kombëtare,ma në fund tue pa se Italijs dita më datë po penetronte në Shqipëri e,tue kuptue se Shqipëria nuk mund të shpëtonte vetëm me fuqit e veta,përfaqsova idë e bashkimit të popujve të ballkanit në gjinin e një Konfederate.

Një bashkim ballkanik,si tash edhe asi koha,e favorizonte Rusia Sovjetike.Por,unë,tuekuptue se,nga frika e komunizms që idë që dilte nga Moskja gjente kundërshtimin e të gjithë oksidentit,kët idë të natës,mendovali a paraqes botës n'aspektin thjeshtësisht kombëtar e të pamvarun nga Moskja.

- Nga ana tjetër nuk mund të mohojë edhe se,unë si nacionalist,edhe vet isha e jam i parimit që idëja e një bashkimit ballkanik të dalë si një vullnet i popujve të Ballkanit tue mos u drejtue Ballkani nga asnjë fuqi e madhe.

Sikundër e kam qragë mendimin t'em dhe në fletoren "BASHKIMI I KOMBIT" me 3 dhjetor 1943,Konfederatën Ballkanike e kam anërrue dhe e kërkoj

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #4

- 4 -

113 29

në mënyrë që secili popull të rregullohet me frymen, karakteristikat dhe vlerat e veta dhe, popujt e Ballkanit, si shtete të bashkueme, në politiken rivale të fuqive të mëdha të mbeten të pa-anshëm për me e ba vendin e tyre në faktori paqeje në Europë dhe në botë. Me këtë frymë e drejtë kam themeluar edhe një grup të vogël nën emrin "PARTIJA NACIONAL-BALLKANIKE SHQIPTAKE", të cilin m'uajt me e shpallë botnisht ndër ditet e rëndit që ishte tue u largue ushtria gjermane nga Shqipëria.

Me gjithë se mendimi i jem ka qenë ky, ma vonë, tue kuptue se realizimi i shpejtë i kësaj idëje, ka nevojë për ndihmën e një shteti të madh, për të parën herë drejtova një "memorandum" presidentit Hoover tue kërkuë ndihmën e Shteteve të Bashkueme të Amerikës. Bashkë me memorandumin pata qenë edhe një ilamur që pata shpallë për konfederatën.

Ndonsë mizerja e mërgimit në kishë randue e turbullue tepër - pse nga mos-pasja, vuerja dhe për bukë e shpesh herë rrija nën ura - po për idën e bashkimit ballkanik i kam pasë drejtue edhe një memorandum Konferencës së parë për afrimin ballkanik që u mbledhë në Athinë me 1931, tue i kallxue asaj konditat mbi të cilat mund të realizohet idëja e bashkimit ballkanik. Kët memorandum e pata botue edhe në formë manifeste tue harxhuë parat e qarasë së hotelit dhe si konseguencë të kësaj veprë pata mbetë dhe pa odë tue u shtrëngue me rrethë për nën ura e disa herë në odën e ndonji shoku.

Ju njoftoj edhe se, ndër të hikunit, jam i vetmi që s'kam pasë marrë rrogë nga ndonji shtet i madh dhe kam jetue gjithnjë tue i lypë shokve e miqve personal. Dikuj i kam marrë parë për me hangër një copë bukë, dikuj tesha me u veshë e dikuj këpucë për me u mbathë e, ndonsë kamen e kanë të numurit 41, të gjitha numurat prej 39 e natë i pranonja...

Jeta e jeme në Paris ka qenë e tmerrshme. Për dhjetë vjetë rresantë e kam ba vet bukën, i kam la vet enët, i kam la vet teshat e çdo natë rrinja me frigë se a do të kisha për me hangër ne të nesërmen, pse shpesh herë më ka qillue me mbetë lare pa të. Dhe, kjo mizerje m'asht shkaktue jo pse edhe unë s'mund të mirrsha ndonji rrogë prej ndonji qeverije, por pse kisha vendosë me luftue fqinjët që paguejshin për arsyenat e tyre politike. Lufta e jeme kundra fqinjve imperialist, ka qenë aq intranzigjente sa që çeshtjen e librit të Kosovës dhe nevojën e një Konfederate Ballkanike, e kam pasë çirë bashkë në Jugosllavin vet dhe si konseguencë të këtij gjest, auktoritetet jugosllave të Sushakut më patën ekspulsue. Kjo më 1927.

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #5

- 5 -

114 30

Prej Jugosllavije shkova në Vjenë por mjerisht edhe prej atje për intrigat e konsullit të Zogut Çetin Saraçit u ekspulsua e menjherë, mbas shumë mundimesh, u nisa për në Francë ku qëndrova deri më 1939.

Ket jetë aktiviteti, persekutimi e mizerje mund të m'a vërtetojnë të gjithë të hikunit si dhe studentat e puntorët shqiptarë që ndodheshin në Paris.

EDHE NJI TJETËR VEPËR QË MË NDERON:

Tue mos gjetë asnjë mbështetje të pa komprometueshme për lëvizjen t'eme shqiptare e ballkanike grupi u shpërndeg, e, si person, inspirue me ndjenja njerzore e paqësore, tue pa padrejtësin e fuqive të mëdha imperialiste si dhe pazotesin e lidhjes së Kombeve për mbrojtjen e të drejtave të secilit popull, më ra ndër mend një idë e re.

Për me i dhënë një ruqë lidhjes së Kombeve dëgjova, për mos me e lanë Institutin e Gjenevës vetëm ndër duart e fuqive të mëdha e pash të dobienme që të gjithë popujt e vegjël të botës të lidhen në një institucion të veçantë tue u organizue ata ma parë në konfederatë. Për realizimin e kësaj idëje i drejtova një memorandum qeveris holandeze tue i sugjerue asaj mendimin që ajo si një shtet i respektuem në botë të merrte inisjativën për realizimin e këtij projekti. Dhe kjo idë e jeme e organizimit të popujve të vegjël në një institucion të veçantë asht e njohur prej shokve të mërgimit pse dhe këto, tue e lanë vedin keq, e kam pasë shtypë dhe shpërndarë ndër broshura. Ma di që unë, një kopje të këtij projekti, gjindet ndër dokumentat që më kam marrë. Mbasi qeverija holandeze nuk më dha një përgjigje të favorshme, projektin t'ëm për bashkimin e popujve të vegjël i a pata dërgue edhe qeveris republikane të Spanjës.

Ket mendimin t'ëm për lidhjen e popujve të vegjël, në një institucion të veçantë - tue u organizue ata ma parë në konfederatë të veçanta - asht koha e patën marrë me talije, por sot kjo idë asht tue u mprojtë edhe prej personaliteteve politike përgjegjëse. Disa muajt ma parë, kam këndue në një fletore ku zoti Smuts - i, president i Afrikës Jugore e apronte me zëhtësi kët mendim.


x x x

TË VIJME TASH TEK ÇESHTJA QË JU INTERESON JUVE:

Tue notue unë në Paris me këto idëna të bukura e bujare që ju çiraq,


Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #6



Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #7



Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #8

- 8 -

pa se ushtrija shqiptare bani fuzion me ate t'Italis, pata kerkue dhe formimin e nji Milicije shqiptare te formueme e te komandume krejtesisht prej shqiptarve tue caktue detyren e sajë për me rruajtë kufijt e Shqipnise.

Kët parti "ROJA KOMBETARE" mendonja me e këtyre ma vonë në nji rrymë e balikanike ashtu si e qpalia me hikjen e gjermanve: Partia NACIONAL-BALLKANIKE Shqiptare - programin e së cilës besoje se e keni lexue.

Kërkesën për me formue këtë Partit i a pata paraqitë inspektorit të Partis Giovanni Giro-s, por ~~më pas~~ m'a refuzoi tue i konsiderue idët e mija separatiste.

I zemruem me Giovanni Giro-n për mos përkrahjen e kesaj kerkese, pata tentue - po për këtë qëllim - edhe me pas-ardhësin e tij Piero Parinin. Këtë tij i pata ba edhe nji telegram urimi kur u ba inspektor i partis. Teksti i këtij telegrami që asht botue në riletoren "FASHISTI" e tregon qëllimin t'ëm.

Në projektin t'ëm, edhe me Parinin s'pata sukses dhe që prej asaj kohe kam qindrue larg partis fashiste. Me gjithse nji herë rrjeshtë me shkrua më ka thirrë partijs për me u betue si antar, unë nuk jam paraqitë. Këta dokumenta mund t'i gjeni ndër letrat që m'i keni marrë.

KE QENË FASHIST

Ndonse unë s'e kam vu asnjherë distinktiven fashiste dhe kam refuzue për me u betue në parti, shum kusni, tue mos i kuptue idët e mija të vërteta, me kanë mbajtë për fashist. Por, në realitet, kjo s'asht e vërtetë. Idët e mija politike janë për demokraci, pse çmoj thellësisht dobën e liris së mendimeve. Vetëm, për Shqipni, tue pa se edhe populli i jonë asht nën influencën patriarkale, feudale e fetare, kam mendue që prej kone organizimin e intelligjencës shqiptare për me i imponue vendit nocionin e shtetit e me aprotë me erikacitet të drejtat e popullit.

Përsëris, e kuptoi pa drejtësin e qenjes së nji partijs të vetme, por, në nji vend si ky i jonë, ku mungojnë edhe udnat, urat e buka e gojës së shumicës së popullit, shum partitja bajnë vetëm rjalë e dame. Veçanrisht, kur nji popull asht abrapa edhe në pikpamjen kulturele, veprimet e shum partinave politike e hutojnë tue i a prishë karakterin e moralin e tij. Me rjalë të tjera unë kam qenë e jam me mendimet e Nacional Çlirimtarës.

JE ANTIKOMUNIST

Edhe kjo s'asht e vërtetë. Komunist nuk jam, por dhe antikomunist jo; dhe prova asht se, tue pasë mundësin, unë kurr nuk e kam dantue ose përbuzë

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #9

- 9 -

ndonji komunist. Bile dhe i kam favorizue e ndihmue në rrasa të ndryshme dhe për këtë mund të ju jap disa prova.

Unë, komunistin nuk e kam quejtë kurr të damshëm për popujt e vegjël. Bile, komunistin e konsideroj nji aletate natyrale të nacionalizms së popujve të vegjël të kërcënuem të gjithë nga imperialismi e fuqive të mëdha.

~~Komunisti, si çdo parti e tjetër, ka të drejtë të jetë e fortë dhe të fitojë. Por, në krah të Komunistit, për shkak të natyrës së tij, ka të drejtë të jetë e fortë dhe të fitojë. Por, në krah të Komunistit, për shkak të natyrës së tij, ka të drejtë të jetë e fortë dhe të fitojë. Por, në krah të Komunistit, për shkak të natyrës së tij, ka të drejtë të jetë e fortë dhe të fitojë.~~

Këtë e kam kuptue qysh me kohë, por, unë tue kuptue edhe se nën ilasurin e komunistëve, mund t'a shtitë, fuqin e shtetit në dorë, jam çiqas gjithmonë kundra sajë tue pranue disa principe t'anës së djetitë. Dhe, në qoftë se kam ekzagjerue ndonji herë me ndonji frazë kundra komunistëve kjo ka ardhë e para se kam dashtë të mbësë në terenin nacional dhe e dyta se për idët e mija në favor të nji konfederacioni ballkanik, autoritetet shqiptare, italgjane e gjermane më kanë konsiderue si komunist. Këtë mund të ja u vërtetoj edhe me nji dokument që kam pasë zanë italgjanve e të cilin e keni ndër letrat që më keni marrë. Kët dokument m'a ka dorëzue nji mik i jem Ahmet Kola prej Mati që e kish gjetë në Burrel kur niken italgjanët. Deri Fiqri Dinua kur i kërkova leje dhe përkrahje për me e shpallë partin t'eme, më tha: "Dhe ti Beqir nuk je tjetër veçse motër e vilia me komunistin".

* * *


PSE KAM KRYESUE FUQINAT VULLNETARE NË KOHËN E ITALIS

Në kohën e okupacionit italgjan dhe unë për dy herë rreshtë kam rekrutue fuqin vullnetare në krahinën e Matës. Për të parën herë pata mledhë 100 veta kur i u deklarue luftë Jugosllavis dhe për të dytën herë në kohën e Mustar Krujës pa grupue 300 veta për me mbajtë qetësin e Matës.

Për herën e parë e pata mbajtë fuqin vetëm dy muaj dhe për të dytën herë vetëm nji muaj e gjysë. Pothoj edhe se, detyrën për me kryesue fuqin e pata kerkue unë vetë dhe nuk më që imponue. Dhe arsyeja e kësaj kerkese asht kjo: tue qenë se unë, tue ndejt 15 vjetë rrjeshtë jashta Atdheut isha ba tepër i huaj për Shqipni e tue çmue se nji ditë do të më duhesh me organizue forca për me luftue me armë okupatorin, me at mënyrë kam dashtë të bij në kontakt me malësorët që nesër, në kohën e dunut të mujshe me dijt me i drejtue për çlirimin e vendit.


Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #10




Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #11




Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #12




Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #13



Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #14



Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

INFORMACION

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript për këtë media.